



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 202/3 Prot.

Tiranë, më 10.02.2022

**V E N D I M**

**Nr. 36, Datë 10.02.2022**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 38, datë 07.02.2022, të paraqitur nga M.S kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Që nga viti 2015 trajtohet me pension minatori sipas ligjit 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”. Në ligjin nr. 29, datë 23.05.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, minatorët e lindur në vitin 1960 janë përjashtuar nga përfitimi i shtesës mbi pension. Mospërfitimi i shtesës prej 1% për çdo vit vjetërsie pune në miniera dhe përfitimi mbas 7 vitesh që parashikon ligji është i qëllimshëm sepse moshë mesatare e minatorëve është 62-63 vjeç dhe në moshën 65 vjeçare shumë pak minatorë mbeten gjallë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e shtesës mbi pensionin e pleqërisë.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dëgjimit për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, garanton mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Subjekti ankues në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pretendon se është diskriminuar nga ligji nr. 29, datë 23.05.2019 *“Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji<sup>1</sup>”*.

Ankuesi me shkresën e protokolluar në Drejtorinë Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Kukës (DRISSH Kukës) me nr. 353, datë 25.10.2019, ka kërkuar për të përfituar shtesë mbi pensionin e pleqërisë sipas ligjit 29/2019.

DRISSH Kukës me shkresën nr. 1545, datë 12.05.2020 ka informuar ankuesin se: *“Mbështetur në nenin 2 dhe nenin 6/c të ligjit 29/2019, të poshtëcituar: “Shtesën mbi pension, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, e përfitojnë edhe personat që marrin pension sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, kur data e lindjes së të drejtës për pension është deri më 31.12.2014”. Nisur nga këto përcaktime, e drejta për të përfituar shtesën mbi pensionin e pleqërisë sipas ligjit 29/2019 iu lind më datë 30.11.2025, kur mbushni moshën për pension të plotë pleqërie sipas nenit 92 të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar”*.

Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, Komisioneri vlerëson se:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>2</sup>, në nenin 131, pika 1, gërma a, ka sanksionuar se: *“1. Gjykata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;”*.

Neni 134 i Kushtetutës ka përcaktuar subjektet të cilat legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

*“Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:*

- a) Presidentit të Republikës;*
- b) Kryeministrit;*
- c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;*
- ç) Avokatit të Popullit;*
- d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;*
- dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute;*
- e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;*
- ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;*
- f) organeve të qeverisjes vendore;*
- g) organeve të bashkësive fetare;*
- gj) partive politike;*
- h) organizatave;*
- i) individëve”*.

<sup>1</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 88, datë 20.06.2019 dhe hyrë në fuqi në datë 05.07.2019.

<sup>2</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

Kështu, mbështetur në legjislacionin e sipërcituar, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit se ligji 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ka përjashtuar minatorët e lindur në vitin 1960, nga përfitimi i shtesës mbi pension, mund të trajtohet nga Gjykata Kushtetuese, si organi kompetent që vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, pasi Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë procedurale për shqyrtimin e këtij pretendimi.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipër cituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, M.S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**